

Memorandum Mirëkuptimi

Ndërmjet

**Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Brendshëm
i cili vepron nëpërmjet Zyrës së Brendshme**

dhe

Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë

Mbi intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore mbi përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore.

Sekretari i Shtetit për Departamentin e Brendshëm, duke vepruar përmes Zyrës së Brendshme, si pjesëmarrës i Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë si pjesëmarrëse e Shqipërisë – këtu e tutje të referuara së bashku si “Pjesëmarrësit”,

DUKE PASUR PARASYSH marrëdhënien bashkëpunuese ndërmjet autoriteteve në Mbretërinë e Bashkuar dhe atyre në Republikën e Shqipërisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

DUKE DËSHIRUAR intensifikimin e bashkëpunimit në lidhje me mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur;

DUKE DITUR se shkëmbimi i informacioneve të përcaktuara qartë mbështet veprimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe krijon mundësi për të siguruar mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;

DUKE DITUR se çdo shkëmbim informacioni duhet të kryhet në përputhje me ligjet, rregulloret dhe politikat e çdo vendi; dhe se duhen zbatuar masat e duhura mbrojtëse për të ruajtur informacionet e shkëmbyera;

Kanë arritur mirëkuptimin që vijon:

I QËLLIMI

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim që të mundësojë shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë të dhënat personale, ndërmjet Pjesëmarrësve për qëllimet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, me qëllim që t'i ndihmojë

Pjesëmarrësit në aktivitetet e tyre për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore, duke rritur ndërgjegjësimin për risqet tek viktimat e mundshme dhe duke ndërmarrë veprime kundër trafikantëve, si dhe për të garantuar një mekanizëm të sigurt nëpërmjet të cilit viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore mund të kthehen në mënyrë vullnetare në shtetin e tyre.

2. Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim gjithashtu që të rrisë bashkëpunimin ndërmjet Pjesëmarrësve në lidhje me identifikimin dhe referimin ndaj të gjitha viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Procesi i identifikimit do të zhvillohet bazuar në mekanizmat zyrtarë të parashtruar nga secila Palë. Aty ku është e mundur, Pjesëmarrësit do të ndajnë praktikën më të mirë për qëllime të përmirësimit të standarteve, ndërkohë që do të sigurojnë mbështetjen e interesave më të larta të viktimës.
3. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të sigurojë më tej se Pjesëmarrësit do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të lehtësuar dhe asistuar kthimin vullnetar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore brenda afateve kohore të arsyeshme, duke treguar vëmendje të veçantë ndaj sigurisë, mbrojtjes dhe mbështetjes së nevojave të viktimës/viktimës së mundshme.
4. Shkëmbimi i informacionit dhe praktika më e mirë, si dhe puna bashkëpunuese, ndërmjet Pjesëmarrësve është një komponent i rëndësishëm dhe në interesat legjitime të luftës ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe për Pjesëmarrësit e këtij Memorandumi Mirëkuptimi është në interesin themelor publik të përdoren informacionet e shkëmbyera për të forcuar përpjekjet e ndalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

II TË PËRGJITHSHME

5. Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë të dhëna personale, duke përfshirë të dhënat personale që lidhen me shtetasit e tyre sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Në Memorandumin e Mirëkuptimit, qëllimet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore përkufizohen si ato që:
 - Parandalojnë dhe luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore;
 - Mbrojnë të drejtat njerëzore të viktimave të trafikimit dhe sigurojnë mbrojtje dhe asistencë për viktimat dhe dëshmitarët;
 - Sigurojnë hetime dhe ndjekje penale efikase; dhe
 - Promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar mbi veprimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

6. Ky Memorandum Mirëkuptimi do t'u mundësojë autoriteteve të shteteve pjesëmarrëse që të shkëmbejnë në mënyrë të sigurt informacione në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, aty ku ai informacion:
 - Asiston në dhënien e masave për të lehtësuar kthimin vullnetar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore; dhe/ose
 - Mbështet përpjekjet për të penguar trafikantët ose për të reduktuar riskun ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore.
7. Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi, përfshi mos-vazhdimin e tij, nëse është e zbatueshme, nuk ka për qëllim që të ndikojë në shkëmbimin e informacioneve ndërmjet Pjesëmarrësve sipas marrëveshjeve të tjera të përcaktuara, me kusht që asnjë informacion i shkëmbyer në përputhje me këto marrëveshje nuk shkëmbehet në një mënyrë që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
8. E gjithë puna sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të kryhet në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse të ligjeve vendase të të dy Pjesëmarrësve dhe detyrimeve të tyre ndërkombëtare (të cilat përfshijnë, në rastin e Zyrës së Brendshme, detyrimet e saj sipas ligjit të BE).
9. "Të dhëna personale" do të thotë (i) për Mbretërinë e Bashkuar, të dhëna të cilat lidhen me një individ të gjallë, i cili mund të identifikohet (a) nga të dhëna ose (b) nga ato të dhëna ose informacione të tjera që janë në zotërim, ose që mund të zotërohen nga kontrollori i të dhënave, dhe përfshijnë çdo shprehje opinioni për individin dhe çdo tregues të synimeve të kontrollorit të të dhënave ose të çdo personi tjetër në lidhje me individin; dhe (ii) për Republikën e Shqipërisë, çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Elementët e përdorur për të identifikuar një person në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë janë numrat e identitetit ose faktorët e tjerë specifikë për identitetin e tij fizik, psikologjik, social dhe kulturor.
10. "Subjekti i të dhënave" do të thotë një individ që është subjekt i të dhënave personale.
11. "Trafikimi i qenieve njerëzore" do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose strehimi i personave, nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës ose forma të tjera të shtrëngimit, grabitjes, mashtrimit, dinakërisë, abuzimit të pushtetit, shfrytëzimi i vulnerabilitetit, ose dhënia, ose marrja e pagesave ose përfitimeve për të marrë aprovimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime të shfrytëzimit. Shfrytëzimi do të përfshijë, minimalisht, prostituimin e të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën e

detyruar ose shërbimet, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve;

12. "Trafikimi i të miturve" do të thotë rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin, shitjen ose rrëmbimin e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, duke përfshirë rastet që nuk përfshijnë një nga mënyrat e parashtruara këtu në paragrafin 10 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi;
13. "Viktimë trafikimi" do të thotë çdo person që është subjekt i trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me përkufizimin në Nenin 4, pika "e" e Këshillit të Konventës Evropiane, "Mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore";
14. "Fëmijë viktimë e trafikimit" do të thotë çdo person i gjallë nën moshën 18 vjeç, i cili është subjekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç parashtrohet në Nenin 3/b. Në rast se mosha e personit nuk është e specifikuar, por ka arsye që nënkuptojnë se personi është fëmijë, ky person duhet të konsiderohet si i tillë dhe do të përfitojë nga Protokollin derisa mosha e atij personi të specifikohet në mënyrë të plotë;
15. "Viktimë e mundshme e trafikimit" do të thotë çdo person fizik që identifikohet si i tillë bazuar në kriteret e parashtruara në legjislacionin e brendshëm ose politikën e çdo Pale, duke marrë në konsideratë gjithashtu zbatimin marrëveshjeve ndërkombëtare tek të cilat aderojnë Pjesëmarrësit;
16. "Fëmijë viktimë e mundshme e trafikimit" do të thotë një fëmijë që është në një situatë serioze, konkrete, dhe aktuale, e cila do të rezultojë në përballjen e fëmijës me një risk të vërtetë trafikimi;
17. Pranimi i një viktime trafikimi për shfrytëzimin e synuar të parashtruar në pikën (a) të këtij neni do të jetë irrelevante aty ku janë përdorur secila prej mënyrave të parashtruara në pikën (a). Pranimi jo i drejtpërdrejtë ose real i fëmijës do të jetë i papranueshëm;
18. "Fëmijë të pashoqëruar" do të thotë çdo person nën 18 vjeç, i cili jeton në territorin e njërit prej Pjesëmarrësve, i cili vshtë ndarë nga prindërit dhe nuk është në kujdestarinë e një të rrituri.

III

PËRCAKTIMI I ZYRTARËVE

19. Secila Palë duhet të përcaktojë zyrtarët në organizatën përgjegjëse, të cilët janë të autorizuar të shkëmbejnë informacione dhe të kërkojnë aktivitete sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe të informojnë Palën tjetër me shkrim ose me email për të gjitha këto përcaktime ose ndryshime. Të gjitha shkëmbimet e

informacioneve dhe përgjigjet ndaj kërkesave të bëra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të komunikohen ndërmjet këtyre zyrtarëve të përcaktuar si pikat kryesore të kontaktit për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Pjesëmarrësve.

20. Secila Palë duhet të emërojë Një Oficer Ndërlidhës, i cili është përgjegjës për të siguruar zbatimin dhe funksionimin e dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
21. Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë çdo vit aktivitetin sipas kësaj marrëveshjeje për të siguruar se ky Memorandum Mirëkuptimi vazhdon të përmbushë qëllimin e tij strategjik.

IV

PROCEDURAT PËR VIKTIMAT/VIKTIMAT E MUNDSHME TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE QË DËSHIROJNË TË KTHEHEN VULLNETARISHT NË VENDIN E TYRE

22. Pjesëmarrësit janë të angazhuar për të zbatuar masat për të lehtësuar dhe asistuar në kthimin vullnetar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore brenda afateve kohore të pranueshme, duke treguar vëmendje të veçantë për sigurinë, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojave të viktimës/viktimës së mundshme.
23. Pjesëmarrësit, në përputhje me procedurat e nënvizuara në seksionet nga 6 në 16 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, do të shkëmbejnë informacione, deri në masën që janë të disponueshme dhe të praktikueshme, për të siguruar se Pala marrëse kupton në mënyrë të mjaftueshme nevojat e veçanta të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore që dëshirojnë të kthehen vullnetarisht.
24. Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë, duke përdoruar mekanizma të sigurt, informacione që mund të lidhen me, por që nuk janë të kufizuara në:
 - Detajin biografik të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore që dëshiron të kthehet vullnetarisht; dhe
 - Detajet e çdo asistence specifike dhe mbështetjeje që kërkohet nga viktimat/viktima e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore që dëshiron të kthehet vullnetarisht, për shembull, gjendja mjekësore ose kriteret për mbështetje.
25. Me marrjen e një referimi, pala marrëse duhet të zbatojë masat e duhura për të lehtësuar kthimin vullnetar dhe ri-integrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Këto masa do të jenë specifike sipas rrethanave dhe nevojave të individit viktimë/viktimë e mundshme e trafikimit të

qenieve njerëzore. Për të shmangur dyshimet, një referim përkufizohet si një pjesëmarrës që informon tjetrin për një viktimë/viktimë të mundshme që dëshiron të kthehet në vendin e tij.

26. Ato masa mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

- Sigurimin/dhënien e trajtimit mjekësor;
- Sigurimin/dhënien e kujdesit shoqëror;
- Aksesin në mirëqënien shoqërore;
- Aksesin në arsimim dhe/ose trajnim;
- Mbështetje për aksesin në tregun e punës;
- Dhënien e sigurisë dhe/ose çdo masë tjetër që mund të reduktojë riskun e ri-trafikimit; dhe
- Çdo mbështetje tjetër që mund të ndihmojë viktimën/viktimën e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore që të ri-integrohet.

27. Aty ku Pjesëmarrësit këshillohen se një viktimë/viktimë e mundshme e trafikimit që ka shprehur dëshirën për t'u kthyer në vendin e vet, nuk dëshiron më që të kthehet, ata duhet të informojnë Palën marrëse sa më shpejt që të jetë e praktikueshme dhe jo më vonë sesa 24 orë pasi janë njoftuar për këtë.

V

PROCEDURAT QË LEHTËSOJNË AKTIVITETIN E PJESËMARRËSVE NË NDALIMIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË BURIM

28. Pjesëmarrësit janë të angazhuar që të zbatojnë masat për të ndaluar trafikimin e qenieve njerëzore në burim, në mënyrë që të reduktojnë riskun ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

29. Pjesëmarrësit, në përputhje me procedurat e dhëna në paragrafet nga 6 në 16 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, do të shkëmbejnë informacione, deri në masën që ato janë të disponueshme dhe të praktikueshme, për të lehtësuar një aktivitet të tillë.

30. Kjo do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- Profilet e atyre që janë të prirur për t'u bërë viktimë/viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore, për shembull moshë, gjinia, ose profilet e arsimimit;
- Zonat gjeografike nga të cilat kanë tendencën për të ardhur viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore; dhe
- Informacione që lidhen me ata që dyshohen se janë të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore.

31. Informacioni i shkëmbyer do të informojë aktivitete për t'u ndërmarrë nga Pjesëmarrësit për të reduktuar riskun ndaj viktimave të mundshme të trafikimit

të qenieve njerëzore në burime. Ky aktivitet mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

- Rritjen e ndërgjegjësimit midis grupeve që mund të jenë veçanërisht në risk për t'u trafikuar;
- Rritjen e ndërgjegjësimit në zona të caktuara gjeografike ku ekziston risku ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore; dhe
- Aktivitetet për të ndaluar trafikantët.

32. Çdo informacion që shkëmbehet për këtë qëllim do të kryhet në përputhje me dispozitat e parashtruara në Seksionin X të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

VI

PROCEDURAT PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT

33. Çdo shkëmbim informacioni duhet të jetë në përputhje me qëllimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe shkëmbimet do të zhvillohen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale ndërmjet Pjesëmarrësve.

34. Pjesëmarrësit kanë për qëllim të ndajnë informacione aty ku Pala dhënëse ka baza të vërteta dhe të arsyeshme për të besuar se dhënia e informacionit është e nevojshme për Palën marrëse për të realizuar qëllimet e tyre që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, siç përkufizohen në paragrafet 1, 2 dhe 3.

35. Secila Palë do të përcaktojë nëse informacioni që mban është i duhur për t'u shkëmbyer me Palën tjetër dhe që një shkëmbim i tillë është i lejuar sipas ligjeve vendase të Palës dhe detyrimeve ndërkombëtare.

36. Aty ku, me marrjen e informacionin të shkëmbyer Pala marrëse gjen informacione shtesë mbi subjektin e shkëmbimit që ajo mund të ndajë, ajo do t'ja sigurojë atë informacion Palës tjetër, në përputhje me ligjet e saj vendase dhe detyrimet ndërkombëtare.

37. Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë informacione në mënyrë proactive dhe/ose në përgjigje ndaj një kërkesë nga Pala tjetër. Çdo kërkesë e tillë do të bëhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale me shkrim ose email, dhe do të japë arsye të mjaftueshme për kërkesa të tilla për t'i mundësuar Palës tjetër të përcaktojë ligjshmërinë e dhënies së një informacioni të tillë.

38. Në përgatitjen e një kërkesë për informacion, Pala kërkuese kupton se kjo nuk vendos asnjë detyrim mbi Palën tjetër për të dhënë informacion. Megjithatë, në varësi të dispozitave të seksionit 7 më poshtë, secila Palë do të bëjë përpjekje për të dhënë informacionet e kërkuara nga tjetra në kohën e duhur.

39. Asnjëra Palë nuk do të shkëmbejë të dhënat personale ku ka një risk se informacioni mund të përdoret për të shkelur detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

VII INFORMACIONET QË MUND TË SHKËMBEHEN

40. Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë, duke përdorur mekanizma të sigurt, informacione që mund të lidhen, por nuk kufizohen në trafikimin e qenieve njerëzore.
41. Informacionet mund të shkëmbehen sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi vetëm deri në masën që është e duhur, e nevojshme dhe e përshtatshme për qëllimet e Pjesëmarrësve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore dhe janë të lejueshme sipas ligjeve vendase të Pjesëmarrësve dhe detyrimeve ndërkombëtare.
42. Pjesëmarrësit duhet të shkëmbejnë informacione vetëm deri në masën që informacionet janë të disponueshme për tad he dhënia është e praktikueshme. Llojet e të dhënave që mund të shkëmbehen mund të përfshijnë, por nuk kufizohen patjetër në:
- Informacionet përkatëse në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore që dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre;
 - Informacione përkatëse në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore për të informuar ndërhyrjet e duhura në burim;
 - Informacione përkatëse në lidhje me trafikantët.
43. Kuptohet qartë se një Palë mund të mos jetë e lirë të shkëmbejë informacione sa herë që përdorimi i transferimit të atij informacioni është i kufizuar me ligj ose me kufizime të tjera vendase, ose varet nga aprovimi i një tjetri (qoftë aprovimi i subjektit të të dhënave ose i një autoriteti ose personi tjetër).
44. Vlera e informacioneve të shkëmbyera dhe kufizimet aty, do të varen nga shqyrtimi i vazhdueshëm dhe diskutimi konstruktiv ndërmjet Pjesëmarrësve.

VIII PËRDORIMI I LEJUAR DHE DHËNIA

45. Në varësi të paragrafeve nga X në Y, secila Palë mund të përdorë informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi për çdo qëllim që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore, siç përkufizohet në paragrafet nga 1 në 3, duke përfshirë procedurat gjyqësore përkatëse. Secila Palë mund të japë, për këto qëllime, informacione tek autoritetet e duhura vendase përgjegjëse për ndjekjen e atyre qëllimeve me nevojën për të ditur të realizojë detyrat e tyre zyrtare.

Pjesëmarrësit duhet të sigurojnë se ato autoritete aplikojnë një nivel mbrojtjeje të atyre informacioneve, dhe kufizojnë përdorimin dhe dhënien e tyre në një mënyrë të ngjashme me atë që pritet nga Pjesëmarrësit sipas dispozitës së këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

IX KUFIZIME NË PËRDORIM DHE DHËNIE

46. Dhënia ose përdorimi i informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi për çdo qëllim ose për çdo person tjetër nga sa parashtrohet në paragrafin 45 do të jetë subjekt i aprovimit paraprak me shkrim të Palës që ka dhënë informacionin.
47. Çdo përdorim ose dhënie informacioni që është marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi parashikohet që të jetë në përputhje me ligjet vendase të zbatueshme të Palës dhe detyrimet ndërkombëtare.
48. Në mënyrë specifike, asnjëra Palë nuk do të shkëmbejë, përdorë ose japë informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, të tilla që mund të bëhen të njohura për çdo qeveri, autoritet ose person nga i cili subjekti i të dhënave kërkon ose i është mbrojtje sipas Konventës së vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, Prokollit të saj të vitit 1967, Konventës kundër Torturës ose Trajtime të tjera Ndëshkimore Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese ose, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose ligjeve vendase të secilës Palë që zbaton Konventat ose Protokollin përkatës. Asnjëra Palë nuk do të shkëmbejë, përdorë ose japë informacione një qeverie, autoriteti ose personi, në rrethana ku, me anë të qeverisë, autoritetit ose personit që vihet në dijeni për një informacion të tillë, subjekti i informacionit mund të bëhet i pranueshëm për një mbrojtje të tillë.
49. Në çdo rast të veçantë, një Palë, nëpërmjet një shënimi mbrojtës ose mënyrë tjetër, mund të aplikojë kufizime shtesë në lidhje me përdorimin ose dhënien e informacionit që ajo ka dhënë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, i cili përfshin sigurimin se ai trajtim informacioni vshtë në përputhje me politikat e zbatueshme në vend, ligjet dhe detyrimet ndërkombëtare. Aty ku realizohet kjo, Pala tjetër pritet që të jetë në përputhje me kufizimet. Këto kufizime mund të mos pengojnë aksesin e subjektit, siç jepet në paragrafin 64.
50. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk ka për qëllim që të pengojë përdorimin ose dhënien e informacionit rast pas rasti deri në masën që ekziston një detyrim për të vepruar kështu sipas ligjeve të Palës Marrëse. Në varësi të kësaj dhe deri në masën që është e praktikueshme, një Palë duhet të njoftojë tjetrën paraprakisht për çdo përdorim ose dhënie informacioni të marrë sipas këtij Memorandumi

Mirëkuptimi, i cili nuk është ndryshe në përputhje me dispozitat e Memorandumit të Mirëkuptimit. Gjithashtu, një Palë marrëse pritet që së pari të kërkojë leje me shkrim nga Pala dhënëse nëse ajo dëshiron të japë një informacion të tillë tek subjekti i të dhënave; një gjykatë, përfshi çdo gjykatë administrative; ose çdo palë të tretë, përfshi shtetet ose entet e treta. Kjo ka për qëllim t'u japë Pjesëmarrësve mundësinë, aty ku është e përshtatshme, për të kërkuar mos-dhënien ose mbrojtje të tjera të informacionit, deri në masën që lejohet nga ligji i Palës marrëse.

X

TRANSFERIMI I INFORMACIONIT

51. Secila palë pritet që të aplikojë minimumi standardet e parashtruara këtu në lidhje me përpunimin dhe mbrojtjen e informacioneve të shkëmbyera. Në mënyrë të veçantë, secila duhet të ruajë të gjitha të dhënat personale të shkëmbyera në një mënyrë të paktën aq të sigurt dhe me privatësi të ngjashme dhe të drejtat për mbrojtjen e të dhënave, përfitimet dhe privilegjet e dhëna për subjektin e të dhënave siç është rasti me vetë shtetasit e saj.
52. Shkëmbimi i informacionit sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të realizohet në mënyrë të sigurt ndërmjet zyrtarëve të përcaktuar. Proceset, formatet dhe emtodat për shkëmbimin e të dhënave duhet të jenë në përputhje, kudo ku është e zbatueshme, me të gjitha standardet dhe proceset, siç mund të vendoset bashkarisht nga Pjesëmarrësit.
53. Informacioni i transmetuar ndërmjet Pjesëmarrësve nëpërmjet transferimit elektronik do të enkriptohet me një standard të aprovuar.
54. Në rast se nuk është i disponueshëm transferimi i sigurt, Pala mund të marrë masa për njërin nga zyrtarët e saj të përcaktuar për të transmetuar informacionin me dorë tek një zyrtar i përcaktuar i Palës tjetër.

XI

SIGURIMI I INFORMACIONIT

55. Informacionet e marra nga Mbretëria e Bashkuar sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të klasifikohen si "Zyrtare", dhe informacionet e marra nga Republika e Shqipërisë do të klasifikohen në një nivel ekuivalent, përveçse kur Pala që ka dhënë informacionet e lejon ndryshe.
56. Secila Palë do të zbatojë masa autentifikimi për të siguruar se aksesit në informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi është shumë i kufizuar. Secila Palë duhet të kufizojë aksesin në informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi tek ai personel i autorizuar që ka nevojë të dijë

informacione për të kryer detyrat e tyre zyrtare, për përdorime që janë në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi.

57. Secila Palë duhet të sigurojë se informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi mbrohen nga shpërndarja e pa-autorizuar.
58. Informacionet e shkëmbyera duhet të mbrohen nga masat administrative, teknike dhe fizike të duhura për sensitivitetin e informacionit. Të dy Pjesëmarrësit, gjatë gjithë kohës, duhet të ruajnë informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në sisteme ruajtjeje të sigurta elektronike dhe/ose në letër.
59. Të gjithë personat që kanë akses në informacionet e marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të jenë arsimuar dhe trajnuar siç duhet në lidhje me trajtimin dhe kufizimet e përdorimit të këtyre informacioneve për të siguruar ruajtjen e përgjithshme të informacionit dhe pajtueshmërinë me këtë Memorandum Mirëkuptimi.

XII INTEGRITETI I INFORMACIONIT

60. Informacionet e dhëna dhe të marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të jenë të sakta, të plota dhe të përditësuara deri në masën maksimale të praktikueshme për qëllime të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Një Palë mund të mos modifikojë asnjë informacion të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi pa autorizimin paraprak me shkrim të Palës që e ka dhënë atë.
61. Nëse cilado prej Palëve vihet në dijeni se ai informacion që ka dhënë ose ka marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi është i pasaktë, ajo palë duhet të këshillojë Palën tjetër dhe të japë informacion të saktë.
62. Çdo pjesë informacioni që jepet nga një Palë duhet të përfshijë detajet e atribuimit të saj; datën e krijimit; klasifikimin e sigurimit; dhe kufizimet mbi ose lejet për përdorim të mëtejshëm, për të asistuar me përpjekje të arsyeshme për të ruajtur informacionet e shkëmbyera të sakta, të plota dhe të përditësuara dhe për të siguruar se ato janë trajtuar dhe përdorur në mënyrën e duhur.
63. Pjesëmarrësit duhet që, në kohën e duhur, të marrin veprimet e duhura në lidhje me çdo kërkesë të bërë nga Pala tjetër për akses, shtesa, ndryshime, fshirje ose korrigjime në informacionin e dhënë, përfshi prishjen e të dhënave aty ku është e përshtatshme.
64. Secila Palë konfirmon se ajo ruan një sistem të aksesueshëm për individët që, pavarësisht nga kombësia ose shteti i vendbanimit të tyre, i lejon ata që të

kërkojnë informacion për ta, i cili është marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe të kërkojnë korrigjim ose koment për atë informacion. Secila Palë konfirmon gjithashtu se ajo siguron mundësi ndreqjeje për personat që kërkojnë një akses, korrigjim apo koment të tillë pavarësisht nga kombësia apo shteti i vendbanimit të tyre.

XIII MBAJTJA E INFORMACIONIT

65. Secila Palë duhet të vlerësojë në vijim relevance e informacioneve të marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi ndaj qëllimeve të saj që lidhen me trafikimin e personave dhe të shkatërrojë informacionet në mënyrë të sigurt kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllime të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
66. Informacionet që përfshihen në një dosje çështjeje në formë elektronike ose në letër në lidhje me një subjekt të dhënash, për shkak se ai ka relevancë të vazhduar, mund të mbahen si pjesë e asaj dosjeje në përputhje me ligjet vendase dhe politikat për mbajtjen e të dhënave të Palës që i ka marrë ato.
67. Informacionet që vendosen në Watchlists, Lookouts dhe Alert Lists, ose ndryshe, të cilat mbahen për përdorim të mundshëm në të ardhmen, mund të mbahen gjithashtu për sa kohë që të jetë e nevojshme për qëllimet përkatëse të Palës, të cilat lidhen me trafikimin deri në një maksimum prej dhjetë vjetësh që nga data e marrjes. Si pjesë e shqyrtimit të vazhduar të këtyre regjistrimeve, Pjesëmarrësit kanë për qëllim të diskutojnë relevancën në vijim të informacionit dhe të kërkojnë aprovim përpara dhjetë vjetësh mbi informacionin e duhur për mbajtje për një periudhë të mëtejshme.
68. Çdo mbajtje përtej asaj të parashtruar në paragrafet nga 65 në 67 është subjekt I aprovimit paraprak me shkrim të Palës që ka dhënë informacionin. Memorandumi të tij të Mirëkuptimit për qëllimet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

XIV NJOFTIME DHE RREGULLIME

69. Për të siguruar masa të mëtejshme për privatësinë, sigurimin, konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe informacioneve që ato ruajnë, përpunojnë dhe transmetojnë, Pjesëmarrësit duhet të njoftojnë Palën tjetër sa më shpejt që të jetë e praktikueshme, por jo më vonë sesa 24 orë pas informimit në lidhje me çdo shkelje të sigurimit të sistemeve të informacionit që përmbajnë, ose përdorimin e pa-autorizuar ose dhënien e informacioneve të dhëna sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

70. Pjesëmarrësit duhet të ndërmarrin veprimet e duhura sipas ligjeve të tyre administrative, civile dhe/ose penale në rast keqpërdorimi, ndryshimi ose fshirje të pa-autorizuar, ose akses ose shpërndarje të pa-autorizuar të informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi nga vetë punonjësit, Agjentët e tyre ose çdo Pjesëmarrës i tretë.

XV

REGJISTRIMI I TRANSAKSIONEVE

71. Pjesëmarrësit do të ruajnë të gjitha regjistrimet e informacioneve të dhëna dhe tv marra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duke përdorur një kuadër të përcaktuar të përbashkët. Kjo është pa paragjykim ndaj asnjë regjistrimi të mëtejshëm që ata mund të mbajnë në përputhje me ligjet e tyre vendase të zbatueshme dhe pilitikat e udhëzimet për mbajtjen e regjistrimeve.

XVI

PËRPUTHJA DHE AUDITIMI

72. Secila Palë mund të kërkojë siguri nga tjetra se mbahen masa të mjaftueshme në lidhje me informacionet e shkëmbyera sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, i cili mund të përfshijë kërkesën e një auditimi të masave mbrojtëse. Një Palë, nga e cila kërkohet një auditim mund të marrë masat që ky të realizohet nga një auditues i duhur, me termat e referencës që do të vendosen bashkarisht nga Pjesëmarrësit.
73. Pjesëmarrësit duhet të bëjnë përpjekje që t'i adresohen çdo mangësie të perceptuar në masat mbrojtëse në vijim të një auditimi sipas paragrafit 72 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Megjithatë, nëse një situatë lindi aty ku një Palë e konsideroi të nevojshme të mos pranonte të shkëmbente informacione të mëtejshme sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në prindje të një resolute për çështjen, pritet që Palës tjetër t'i jepet njoftimi me shkrim. Ky njoftim do të jetë subjekt i konsultimit të menjëhershëm ndërmjet Pjesëmarrësve.

XVII

RAPORTIMI I PERFORMANCËS DHE MENAXHIMIT

74. Çdo vit Pjesëmarrësit do të përgatisin bashkarisht një raport mbi volumin e shkëmbimeve të informacionit që realizohen; llojin e informacionit që shkëmbehet; rastet në të cilat shkëmbimi ka dhënë një kontribut të dukshëm tek përpjekjet për të penguar trafikimin në burim; dhe rastet në të cilat shkëmbimi ka dhënë një kontribut të qartë në kthimin e suksesshëm vullnetar dhe ri-integrimin e një viktime/viktimit të qenieve njerëzore. Raporti do të bazohet në performancën e përbashkët të përcaktuar dhe masat menaxhuese dhe do të përfshijë, por nuk do të kufizohet, në numrin dhe rreptësinë e të gjitha shkeljeve

të sigurimit/privatësisë të informacioneve të shkëmbyera sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimim, si dhe një përmbledhje të të gjitha veprimeve rregulluese të ndërmarra. Raporti do të paraqitet tek Drejtori i duhur në secilën prej Organizatave.

XVIII MODIFIKIMI DHE KONSULTIMI

75. Pjesëmarrësit kanë për qëllim që të informojnë njëri-tjetrin për të gjitha ndryshimet në ligjet, politikat e tyre përkatëse ose detyrimet ndërkombëtare që mund të prekin materialisht funksionimin ose interpretimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
76. Pjesëmarrësit mund të modifikojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi kohë pas kohe, siç vendosin bashkarisht me shkrim dhe, ndryshe, bëjnë ndryshime në funksionimin e tij, siç jepet nga dispozitat e tij specifike, me kusht që ky modifikim dhe ndryshimet të jenë në përputhje me qëllimin fillestar dhe natyrën e Memorandumit të Mirëkuptimit.

XIX ZBATIMI DHE INTERPRETIMI

77. Ky Memorandum Mirëkuptimi shpreh mirëkuptimin e Pjesëmarrësve. Ai nuk ka për qëllim të krijojë detyrime ligjore, as të krijojë ose japë ndonjë të drejtë, privilegj ose përfitim për asnjë person ose palë, private apo publike.
78. Të gjitha ndryshimet ndërmjet Pjesëmarrësve, të cilat lindin nga interpretimi, zbatimi ose aplikimi i cilitdo aspect të kësaj marrëveshjeje mund të zgjidhen me konsultim reciprok pa referencë ndaj asnjë pale të tretë ose gjykate ndërkombëtare.
79. Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk duhet të konsiderohet për të parandaluar cilindo Palë nga bashkëpunimi ose dhënia e asistencës në përputhje me dispozitat e traktateve dhe marrëveshjeve të tjera të zbatueshme ndërkombëtare, marrëveshjet e tjera, ligjet vendase dhe praktikat përkatëse.

XX
FINANCIMI


80. Pjesëmarrësit do të mbulojnë vetë kostot e tyre dhe do të shfrytëzojnë pajisjet dhe burimet e tyre të personelit për të kryer aktivitetet e tyre sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

XXI
FILLIMI DHE MOSVAZHDIMI

81. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në ditën që ai nënshkruhet nga të dy Pjesëmarrësit. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi mund të fillojë me konfirmimin nga të dy Pjesëmarrësit që janë të përgatitur për zbatimin, i cili përfshin modalitetet për funksionimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi në mënyrë të papërcaktuar, përveçse kur nuk vazhdohet sipas paragrafit 82.
82. Me përjashtim të atyre që jepen në paragrafin 73 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pjesëmarrja në këtë Memorandum Mirëkuptimi duhet të vazhdojë derisa ose përveçse kur një Palë dëshiron të mos vazhdojë aktivitetet e saj sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në një rast të tillë duhet të japë njoftim me shkrim prej 90 ditësh.
83. Nëse aktivitetet ndërpriten të dhënat që janë marrë nga Pjesëmarrësit do të mbahen për përdorim dhe pastaj do të shkatërrohen, në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
84. Pjesëmarrësit konfirmojnë përsëri angazhimin e tyre për të punuar dhe shkëmbyer informacione që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë Memorandum Mirëkuptimi. Me përjashtim të atyre rrethanave, që nuk ka gjasa të ndodhin, të cilat specifikohen dhe kërkojnë zgjidhje sipas paragrafit 82, të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, secila Palë ka për qëllim që të vazhdojë plotësisht këtë bashkëpunim besnikërisht.

Nënshkruar në Londër më 4 dhjetor 2014 në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, të dyja tekstet janë njëlloj autentike.

Z. Saimir Tahiri
Ministritë së Punëve të Brendshme
në Republikës së Shqipërisë


E drejta nderuari Theresa May MP
Sekretari i Shtetit për Departamentin e Brendshëm
në Mbretërinë e Bashkuar